



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4858 / Prot

Gramsh më, 07-01-2021 .12.2020

V E N D I M

Nr. 90 dt. 28/12/2020

“ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e tokës, në banesën e z. Xhaferr Kola, banues në fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblim financiar”.

Këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28 /12/2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit : “ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e banesës së z. Xhaferr Kola, banues në fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblim financiar”, bazuar në :

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 542 061 x 50% = 771 031** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Xhaferr Kola** është në **771 031** (shatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tridhjetë e një) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **771 031** (shatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tridhjetë e një) lekë, për shtetasin **Z. Xhaferr Kola**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini

Miratoi : G.Lena

Pranoi: G.Lena

Dosja nr: _____

KRYETARI I KËSHILLIT

GRETA LENA

